

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P.nr. 123/08

1 Nëntor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, me trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësja e EULEX-it Caroline Charpentier si Kryetare e Trupit Gjykues, dhe Gjykatëset e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Christine Lindemann-Proetel, si anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Noora Aarnio si Procesmbajtëse në çështjen penale kundër;

B. I., i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorit Publik: nr. 109/2008 të datës 17.11.2008 të paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 17 Nëntor 2008 dhe siç është konfirmuar me Aktvendimin mbi Konfirmim të Aktakuzës të datës 18 Maj 2010, Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes (Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK),

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 1 Nëntor, në praninë e të akuzuarit **B. I.**, Avokatit të tij Mbrojtës A. L., Palëve të Dëmtuara **S. S.** dhe **H. S.**, Përfaqësuesit të Autorizuar të Palëve të Dëmtuara Sheremet Ademi dhe Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem, pas shqyrtimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 1 Nëntor 2010, sipas Nenit 392 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), ka shpallur – në të njëjtën ditë – publikisht dhe në praninë e të akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Palëve të Dëmtuara, Përfaqësuesit të Autorizuar të tyre dhe Prokurorit Publik të EULEX-it, këtë

AKTGJYKIM

Akuza për Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes nga Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK kundër të akuzuarit **B. I.**, nuk ka nofkë, i biri i ... dhe ..., i lindur më ... në Mitrovicë, Kosovë, i etnisë Shqiptare, banor i Mitrovicës, i vejë, niveli përfundimtar i arsimimit shkolla fillore, i papunë, me gjendje të varfër ekonomike, shumë dënime të njohura të mëparshme, në paraburgim nga 13 Tetori 2008 deri në 18 Tetor 2009, refuzohet sipas nenit 389 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

-sepse më 1 Nëntor 2010 në seancën e shqyrtimit gjyqësor prokuroria i ka tërhequr akuzat kundër **B. I.** dhe palët e dëmtuara nuk kanë vazhduar me ndjekjen penale subsidiare.

Shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga burimet buxhetore sipas Nenit 103 paragrafi (1) i KPPK.

Arsyetimi

Në aktakuzën PP.nr. 109/2008 të datës 11 Nëntor 2008 të konfirmuar me Aktvendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës të datës 18 Maj 2010, **B. I.** është akuzuar për Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes (Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK).

Më 1 Nëntor 2010, dita e parë e shqyrtimit gjyqësor, pas ekzaminimit të njëres prej dy palëve të dëmtuara, të dëgjuar në rolin e dëshmitarit, dukej se dëshmitari kryesor e mohoi tërësisht pjesëmarrjen e të pandehurit në vjedhjen e rëndë dhe vazhdoi me identifikimin e dikujt tjetër. Pas ballafaqimit të dëshmitarit me provat e përfshira në dosje të lëndës, siç është deklarata që ai ia ka dhënë policit në ditën e sulmit, prokuroria i ka tërhequr akuzat kundër **B. I.**

Palët e dëmtuara nuk kanë vazhduar me ndjekjen penale subsidiare.

PRANDAJ, sipas Nenit 389 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) akuzat për Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK kundër të akuzuarit **B. I.** janë **refuzuar**.

Pasi që akuzat kundër **B. I.** janë refuzuar, shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga burimet buxhetore sipas Nenit 103 paragrafi (1) të KPPK.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë
P.nr. 123/2008

Përgatitur në Anglisht, si gjuhë e autorizuar.

Noora Aarnio
Procesmbajtëse

Caroline Charpentier
Kryetare e Trupit Gjyqësor

¹ Faqja e fundit e versionit anglisht përmban nënshkrimet e dy anëtarëve të Trupit Gjyqësor: Hajnalka Veronika Karpati dhe Chrisitne Lindemann-Proetel dhe këshillën juridike: Aktgjykimi u bë i plotfuqishëm më 9 Nëntor 2010 dhe në versionin shqip kjo faqe mungon.